



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM / KANCELARIJA GENERALNOG
REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

Nr. dokumentit: 23.0.10-2010-08

**RAPORT I AUDITIMIT PËR
IMPORTIM, BLERJE VENDORE DHE SHKËMBIME TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS PËR
VITIN 2010**

Prishtinë, Maj 2011

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
I. Hyrje	5
II. Opinioni i vitit të kaluar.....	6
III. Historiku	6
IV. Bilanci Elektroenergjetik për 2010	8
V. Buxheti i shpenzuar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar	8
VI. Raportimi	9
VI.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm	9
VI.2 Cilësia e informatave	10
VII. Realizimi i Buxhetit	11
VII.1 Subvencionet.....	11
VII.2 Shpenzimet.....	12
VIII. Kontrolli mbi menaxhimin.....	16
VIII.1 Sistemi i kontrollit të brendshëm	16
VIII.2 Auditimi i brendshëm	16
IX. Një konkluzion i përgjithshëm mbi Menaxhmentin e KEK	17
Shtojca I. Komentet e KEK-ut dhe përgjigjja e ZAP-it	18

Lista e shkurtesave

AB	Auditimi i Brendshëm
AP	Auditori i Përgjithshëm
EFET	Federata Evropiane e Tregtareve të Energjisë
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KESH	Korporata Energjetike Shqiptare
KRPP	Komisioni Rregullator i Prokurimit Publik
LPP	Ligji nr.02/L-99 për Prokurimin Publik i ndryshuar dhe plotësuar më 8 shkurt 2007. Përfshirë ligjin e ri, nr. 03/L-241 në fuqi prej 01 dhjetor 2010.
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe e Financave
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minierave
NP	Ndërmarrje Publike
ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI)
PF	Pasqyrat Financiare
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI)
SNK	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (IPSAS)
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZRRE	Zyra Rregullative e Energjisë

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), ka kryer auditimin menaxherial për importin, blerjet vendore dhe shkëmbimet e energjisë elektrike për vitin 2010.

Auditimi jonë është kryer, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të hartuara nga INTOSAI (SNISA) duke përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme, për të dhënë një konkludim rreth menaxhimit të procesit të importit, blerjes vendore dhe shkëmbimeve të energjisë elektrike.

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka menaxhuar subvencionin qeveritar në përputhje me qëllimin e dedikuar në marrëveshjen MEF-KEK. KEK-u kishte siguruar disa kontrata fleksibile për disa lloje të energjisë elektrike, duke arritur të rrisë furnizimin (importin) dhe të ndikojë në optimizimin e sistemit elektroenergjetik të vendit. Këto forma të kontratave janë të nxjerrura sipas rregullave të Federatës Evropiane të Tregtareve të Energjisë (EFET).

Mirëpo, edhe përkundër kësaj KEK-u nuk kishte arritur të shpenzojë të gjitha mjetet e dedikuara për import të energjisë elektrike për vitin 2010. Në të njëjtën kohë furnizimi më energji elektrike nuk ishte stabil (në këtë periudhë kishte reduktime ndaj konsumatorëve).

KEK-u gjatë vitit 2010 kishte realizuar shkëmbime të energjisë elektrike kryesisht me Korporatën Energjetike Shqiptare (KESH). KEK-u kishte eksportuar me shume në krahasim me importet për 23,813 MWh.

Derisa prodhuesit vendor të energjisë nuk kishin ofruar planifikim të mirë për kapacitetet e tyre prodhuese. Ndërsa KEK-u nuk kishte arritur t'i përmbushë me kohë të gjitha obligimet e kontraktuara ndaj tyre (vonesa gjatë ekzekutimit të pagesave).

Me qëllim që të përmirësohet funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrolleve të brendshme, ne ju rekomandojmë që të siguron:

- Informacione dhe regjistrime të mjaftueshme për subvencionet e pranuar nga qeveria;
- Shfrytëzim optimal të mjeteve duke pasur objektivë, stabilizimin me energji elektrike;
- Kontrolle adekuate në regjistrimin e të dhënave dhe procesin e pagesave; dhe
- Menaxhim të mirë të blerjeve të energjisë nga prodhuesit vendor.

Dobësitë e vërejtura tregojnë se sistemi i kontrollit të brendshëm kërkon të përmirësohet. Në lidhje me këtë rekomandim jonë i përgjithshëm për Bordin e KEK-it është që të forcojë nivelin e menaxhimit të përgjithshëm në procesin e importimit, blerjeve vendore dhe shkëmbimeve të energjisë, duke pasur objektivë stabilizimin e furnizimit më energji elektrike në vend.

Menaxhmenti i KEK-it është pajtuar me të gjeturat dhe konkludimet tona në këtë raport, dhe është zotuar se do të bëjë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

I. Hyrje

Ky auditim i KEK-ut ka të bëjë me Subvencionin Qeveritar për importim të energjisë elektrike, blerjen e energjisë brenda vendit dhe shkëmbimet e energjisë elektrike gjatë vitit 2010.

Në bazë të kërkesave ligjore KEK-u ka lidhur kontratë me një firmë private të auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare për vitin 2010.

Bordi i KEK-ut është përgjegjës për raportimin lidhur me shpenzimin e Subvencionit Qeveritar për importim të energjisë elektrike, në bazë të marrëveshjes për Monitorim dhe Kontroll ndërmjet Ministrisë për Ekonomi dhe Financa (MEF) dhe KEK-ut.

Në këtë auditim ne kemi analizuar:

- Nëse mjetet e dhëna nga BKK për import (subvencionet) janë menaxhuar dhe shpenzuar në mënyrë të duhur dhe për qëllimin e caktuar në marrëveshje;
- Nëse raportet lidhur me shpenzimet për importim dhe blerje të energjisë japin një pamje të drejtë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Të gjitha çështjet tjera të cilat dalin apo kanë të bëjnë me importim, blerje dhe shkëmbim të energjisë elektrike.

Fillimisht ne kemi kryer auditimin e përkohshëm në KEK, duke trajtuar adresimin e rekomandimeve të mëparshme si dhe cilësinë e menaxhimit financiar. Kemi këshilluar menaxhmentin për adresimin e çështjeve lidhur me importet dhe blerjet vendore të energjisë, përmes memorandumit të auditimit i cili është dorëzuar në dhjetor 2010.

Në këtë auditim, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar raportet për importim dhe blerje vendore të energjisë në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2010;
- Kemi përcaktuar nëse këto raporte janë përgatitur në pajtim me SKK – SNK dhe kërkesat e aplikueshme;
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të të hyrave dhe shpenzimeve, si prag për lehtësimin e përcaktimit të konkludimit tonë mbi pasqyrat dhe raportet financiare;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;

- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare; dhe
- Kemi vlerësuar cilësinë e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm në KEK lidhur me fushën e importit dhe blerjeve vendore të energjisë.

Në auditimin tonë ne nuk kemi adresuar arsyet e mungesës së energjisë elektrike. As nuk e kemi vlerësuar menaxhimin e përgjithshëm të sistemit nga prodhimi deri të furnizimi i konsumatorit.

II. Opinioni i vitit të kaluar

Vitin e kaluar Pasqyrat Financiare të KEK-ut janë audituar nga kompania private e auditimit Deloitte. Për Pasqyrat Financiare të vitit 2009 ishte dhënë *Opinion i kualifikuar*.

Bazat për kualifikimin e opinionit ishin kufizimet në fushëveprimin e auditimit sa i përket: saktësisë së zhvlerësimit të pronës, mospjesëmarrja e auditorit në numërimin fizik të stokeve më 31 dhjetor 2009 dhe mos llogaritja siç duhet e tatimit në fitim për fund vitin 31 Dhjetor 2009.

Si çështje tjetër e theksuar ishte vazhdueshmëria e varësisë nga grandet Qeveritare për importim të energjisë elektrike si dhe niveli i lartë i humbjeve të akumuluar, që ngre dyshime për aftësinë e KEK-ut për te vazhduar në vijimësi.

Sa i përket menaxhimit të Subvencionit Qeveritar për importim të energjisë elektrike nuk ishte theksuar diçka e veçantë.

III. Historiku

KEK sh.a. është Ndërmarrje Publike – Qendrore e organizuar si Shoqëri Aksionare dhe është ndërmarrja e vetme energjetike në Republikën e Kosovës.

Funksionet parësore të Korporatës janë prodhimi i qymyrit, prodhimi i energjisë elektrike, shpërndarja e saj. Përveç kësaj: shërbimi i shitjes dhe përkujdesja ndaj konsumatorit.

KEK-u është e licencuar për furnizim dhe tregtim – import / eksport të energjisë elektrike në Kosovë.

KEK-u ka obligim të përgjithshëm të siguroj furnizim të qëndrueshëm të energjisë elektrike për konsumatorët e saj, nga prodhimet vendore ose jo vendore.

Rrjedhimisht KEK-u ka obligimin e importimit të energjisë elektrike për plotësimin e nevojave të konsumatorëve, për ato periudha kohore kur furnizimet me energji elektrike janë të pamjaftueshme.

Nëse energjia elektrike nuk importohet, konsumatorët do t'iu nënshtrohen reduktimit.

KEK-u gjatë vitit 2010 nuk kishte arritur të siguroj energji elektrike të mjaftueshme për konsumatorët e vendit.

Importimi është parashikuar në Bilancin Elektroenergetik vjetor të vendit të cilin e miraton Ministria që është përgjegjëse për sektorin e energjisë.

Sipas këtij Bilanci, KEK-u si furnizues publik dhe ndërmarrje e licencuar për import ka organizuar dhe kryer importin e energjisë elektrike. Ky import duhet të kryhet në pajtim me ligjet e aplikueshme të konkurrencës dhe ndihmën shtetërore.

Financimi i importit të energjisë elektrike ishte bërë nga mjetet e Buxhetit të Kosovës nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

KEK-u gjatë vitit 2010 kishte lidhur kontrata të formave të ndryshme për importim të energjisë elektrike, më qëllim të optimizimit të sistemit elektroenergetik, siç janë:

- Kontrata për Blerjen e Energjisë së Modular, e cila nënkupton importim të energjisë zakonisht prej orës 07 deri në ora 23. Kjo është forma më e shpeshtë e kontraktimit;
- Kontrata për Blerjen e Energjisë së Pik-ut, e cila nënkupton importim të energjisë prej orës 18 deri në ora 23, në kohën kur konsumi është më i lart dhe nuk mund të mbulohet as me importin e modular;
- Kontrata për Blerjen e Energjisë Emergjente, që nënkupton importim të energjisë e cila planifikohet të ekzekutohet vetëm për raste të pa parashikueshme, në rast kur njësitë prodhuese kanë renë nga sistemi;
- Kontrata për Blerjen e Energjisë Day-ahead, e cila mund të ekzekutohet vetëm në rastet e nevojshme (në mungesë të energjisë që nuk mund të mbulohet nga prodhimi) dhe porosia e saj mund të bëhet vetëm një ditë përpara; dhe
- Kontrata për Blerjen e Energjisë në rrjet, e cila nënkupton importim të energjisë gjatë 24 orëve në ditë, kjo formë e kontratës rrallë ekzekutohet pasi që KEK-u gjatë natës ka tepriçë të energjisë elektrike.

Importimi është kontraktuar nëpërmjet procedurave të prokurimit sipas Ligjit të Prokurimit Publik në Kosovë dhe janë realizuar gjatë vitit 2010. Format e ndryshme të kontratave i mundësonin KEK-ut një fleksibilitet dhe do të duhej të sigurojnë furnizim më efikas të energjisë elektrike.

IV. Bilanci Elektroenergjetik për 2010

Bilanci Elektroenergjetik është plan vjetor i cili paraqet prodhimin vjetor të energjisë, importin për mbulimin e mungesave të energjisë, si dhe eksportin e energjisë elektrike për shkak të plasmanit të tepricave.

Në vijim paraqesim realizimin e Bilancit Elektroenergjetik gjatë vitit 2010, sipas të dhënave të prezantuara nga KEK-u.

REALIZIMI I BILANCIT ELEKTROENERGJETIK 2010				
Përshkrimi	Planifikimi për vitin 2010	Realizimi për vitin 2010	Realizimi për vitin 2009	Pjesëmarrja në % për vitin 2010
	MWh	MWh	MWh	%
Prodhimi nga TC Kos. A	1,410,360	1,684,789	1,424,137	29%
Prodhimi nga TC Kos. B	3,238,194	3,195,094	3,251,728	55%
Prodhimi nga HC Ujman	68,000	115,460	88,667	2%
Importi me kontrata	859,990	684,948	610,509	12%
Importi nga shkëmbimet		131,638	147,913	2%
Total prodhimet / importet	5,530,474	5,811,929	5,522,954	100%
Konsumi Bruto në total	5,343,412	5,465,265	5,241,901	91%
Eksporti me kontrata	224,214	195,220	264,895	3.2%
Eksporti me shkëmbim		155,451		2.6%
Reduktimet	82,506	194,911	381,065	3.2%
Total shpenzimet / eksportet	5,679,778	6,010,847	5,887,861	100%

Në këtë auditim nuk i kemi analizuar arsyet e mungesës së energjisë elektrike. As nuk kemi vlerësuar menaxhimin e sistemit nga prodhimi deri të furnizimi i konsumatorit.

Ky auditim përfshinë vetëm procesin rreth e menaxhimit të Subvencionit Qeveritar për importim, blerje vendore dhe shkëmbimeve të energjisë elektrike.

V. Buxheti i shpenzuar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Importi i planifikuar në Bilancin Energjetik për vitin 2010 ishte 859,990 MWh.

Për mbulimin e importit në vitin 2010 KEK-u kishte planifikuar vlerën financiare prej 45,000,000€ Prej tyre 10,000,000€ MEF-i i kishte transferuar në Dhjetor të vitit 2009, për të mbuluar tremujorin e parë të vitit 2010. Ndërsa pjesa tjetër e mjeteve u miratua nga Kuvendi i Kosovës në Ligjin e Buxhetit për vitin 2010.

Në fillim ishin aprovuar 40,000,000€ për subvencion, ndërsa më rishikim të buxhetit kjo vlerë zbritet në 35,000,000€

Tabela: Përshkrimi i buxhetit në raport me ndarjet nga BKK dhe Shpenzimi i tyre

Përshkrimi	Planifikimi	Buxheti nga BKK 2010	Buxheti nga BKK ne vitin 2009 për 2010	Shpenzimet 2010	Shpenzimet 2009
Importi në €	45,000,000	35,000,000	10,000,000	39,685,409	46,268,817
Importi më kontrata në MWh	859,990			684,948	610,509
Importi nga shkëmbimet në MWh				131,638	147,913

Tabela tregon se ndarja e buxhetit nga BKK ishte e barabartë me vlerën e planifikuar për importim të energjisë elektrike.

Në vitin 2010 KEK-u importoi 74,439 MWh energji më shumë se në vitin 2009, derisa shpenzimi është më i vogël për 6,583,408€

Çmimi mesatar i energjisë ishte me i ulët për 17.8€për MWh krahasuar me 2009. (në vitin 2010 ishte 57.94€ në raport më 2009 që ishte 75.79€për MWh).

Konkluzioni

Me përjashtim të ndryshimeve të paraqitura ndërmjet buxhetit të aprovuar dhe shpenzimeve, KEK-u kishte bërë importin e energjisë në përputhje më Bilancin Elektroenergjetik të miratuar nga Ministria, si dhe mjetet i ka shpenzuar në përputhje më qëllimin e subvencionit qeveritar.

VI. Raportimi

VI.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm

Bazuar në kërkesat ligjore mbi raportimin e NP-ve, sipas SNRF dhe sipas marrëveshjes për monitorim ndërmjet MEF dhe KEK-ut, nga KEK-u duhet të raportoj si në vijim:

- a) Raporte tremujore dhe raportin vjetor të ndërmarrjes për aksionarin (MEF-in);
- b) Pasqyrat financiare vjetore;
- c) Raporte tremujore dhe vjetore për ZRRE-në; dhe
- d) Raporte tremujore dhe vjetore mbi Subvencionet, në bazë të marrëveshjes për Monitorim dhe Kontroll (MEF-KEK).

Raportimet e KEK-ut në bazë të Marrëveshjes që ka me MEF-in për Monitorim dhe Kontroll të Subvencioneve për financimin e importit të energjisë elektrike ishin objektivë kryesore e auditimit tonë.

Raportimi është bërë në periudha tre mujore, në të cilin janë përfshirë mjetet e aprovuara nga MEF-i, shpenzimet e bëra për import dhe mjetet e transferuara (MEF në KEK) për periudhën raportuese.

VI.2 Cilësia e informatave

KEK përdor sistemin (softuerin) informativ të kontabilitetit CAS. ky softuer ka module të ndryshme prej të cilave të dhënat përdorën si input për Librin Kryesor dhe për përgatitjen e raporteve dhe Pasqyrave Vjetore Financiare. Kontabiliteti mbahet në bazë të parimit aktual, sipas SNK-ve. Gjatë rishikimit të Pasqyrave Vjetore Financiare të vitit 2010 auditimi ynë shpalosi të gjeturat në vijim:

- KEK nuk kishte siguruar regjistrime të duhura dhe informacione të mjaftueshme në pasqyra lidhur më subvencionin Qeveritar; dhe
- Regjistrime të faturave në kode të gabuara në kontabilitet në vlerë prej 60,990€ Kjo vlerë u korrigjua nga zyrtaret e KEK-ut në kohën sa ishim në auditim. Mirëpo, këto raste tregojnë se mungojnë kontrollet e mira financiare.

Mungesa e informacioneve të plota rreth subvencionit dhe mungesa e regjistrimeve të duhura kontabël mund të vejë në dyshim besueshmërinë e raportimit. Këto mangësi mund të sjellin edhe devijime nga parimet kontabël.

Konkluzioni

KEK-u ende nuk ka arritur të siguroj një funksionim të mirë të kontrollit të brendshëm që do të siguronte cilësi dhe besueshmëri të informacioneve që përmbajnë pasqyrat financiare. Andaj në të ardhmen duhet të angazhohet që regjistrimet të jenë të plota e të besueshme në përputhje me standardet e aplikueshme.

Rekomandimi 1

Ne rekomandojmë Bordin e KEK-ut të siguroj se Drejtori merr veprime të menjëhershme për të siguruar:

- Regjistrime të transaksioneve lidhur me grantin e qeverisë dhe prezantim të informatave të mjaftueshme në pasqyra financiare; dhe
- Kontrole gjatë regjistrimit të faturave, në mënyrë që të parandalohen të gjitha gabimet apo parregullsitë e mundshme.

VII.Realizimi i Buxhetit

VII.1 Subvencionet

Subvencioni qeveritar i aprovuar për KEK-un për vitin 2010 ishte 45,000,000€ Ndërsa mjetet e transferuara nga MEF-i në KEK ishin 39,020,995€ (10,000,000€ në vitin 2009). Këto mjete janë transferuar në xhirollogarinë kryesore të KEK-ut.

Në vijim po e paraqesim subvencionin në formë tabelore (në €).

Të aprovuara nga BKK	Të transferuara nga MEF-i 2009	Të transferuara nga MEF-i 2010	Total mjetet e transferuara	Të pa transferuara (mbetja)
45,000,000	10,000,000	29,020,995	39,020,995	5,979,005

Shpenzimet e KEK-ut për import të energjisë elektrike gjatë vitit 2010 ishin 39,685,408€ Pasi që MEF për këtë periudhë i kishte transferuar 39,020,995€ KEK-u kërkon ti transferohen edhe 664,413€ për të kompensuar vlerën e shpenzimeve nga importi. Për këtë vlerë shpenzimi ka ndodhur në dhjetor të vitit 2010, ndërsa faturat ishin dorëzuar në muajin janar të vitit 2011.

Ne testuam në përgjithësi subvencionin e shpenzuar dhe shpalosëm të gjeturat në vijim:

Diferenca në mes të dhënave të prezantuara nga MEF dhe të dhënave të KEK-ut

Thesari në MEF ka raportuar subvencione për KEK-un në vlerë 29,035,995€ derisa në xhirollogarinë e KEK-ut ishin transferuar 29,020,995€ apo 15,000€ më pak. Kjo vlerë nuk i është transferuar KEK-ut, por ishte shpenzim i MEF-it për trajnimin e stafit të saj.

Shfrytëzimi jo i plotë i subvencionit, derisa furnizimi me energji nuk ishte i qëndrueshëm

KEK nuk kishte arritur ti shfrytëzoj të gjitha mjetet nga subvencionin, përkatësisht 5.314,592€ apo rreth 12% të mjeteve. Në këtë kohë furnizimi me energji elektrike nuk ishte i qëndrueshëm dhe gjatë tërë periudhës kishte reduktime ndaj konsumatorëve.

Konkluzioni

KEK-u, nuk kishte arritur të realizoj objektivat lidhur me furnizimin me energji. Konkretisht nuk ka arritur të stabilizoj furnizimin me energji elektrike, pavarësisht faktit se kishte mjete ne dispozicion për më shumë import.

Rekomandim 2

Ne rekomandojmë Bordin e KEK-ut të siguroj:

- Menaxhim efikas të mjeteve nga subvencionet për të siguruar furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike për konsumatorët e vendit.

VII.2 Shpenzimet

2.1 Importi i Energjisë Elektrike

Shpenzimet aktuale për importin e energjisë elektrike për vitin 2010 ishin 39,685,409€

- Kemi rishikuar procesin e importimit të energjisë elektrike nga KEK-u;
- Kemi ekzaminuar dy tender për importim të energjisë elektrike për periudhën 2010; si dhe
- Kemi testuar 16 pagesa (fatura) të importit të energjisë gjatë vitit 2010 në vlerë prej 20,733,176€ ose rreth 52% e vlerës totale të importit.

Procesi i importimit të energjisë elektrike dhe kontraktimet realizohen në përputhje me procedurat e përcaktuara me kornizën ligjore të prokurimit.

Pasi që ofertuesit për furnizim me energji elektrike janë kryesisht kompani të jashtme, Menaxhmenti i KEK-u kishte vendosur që formën standarde të kontratës në dosje tenderit ta zëvendësoj më formën e kontratës standarde sipas rregullave të EFET-it.

Këto forma të kontratës janë përpiluar për përdorim në tregun energjetik dhe kushtet e saja të përcaktuara parashohin fleksibilitet më të madh duke reflektuar kushte specifike në tregun e energjisë. Si rezultat i këtyre kushteve KEK-ut i është dhënë mundësia për të kursyer mjete financiare dhe ta stabilizojë sistemit elektroenergjetik.

Të gjitha pagesat lidhur me faturat e lëshuara nga furnitorët e energjisë elektrike, KEK i bënë nga mjetet vetanake.

Pastaj dokumentacioni përkatës i pagesave dorëzohet në MEF, dhe MEF-i transferon subvencionin apo një pjesë të tij në KEK, brenda një periudhe të caktuar kohore.

Auditimi ynë ka shpalosur të gjeturat në vijim:

Kontratat për importim të energjisë janë vetëm në gjuhën angleze

Për arsye që kontratat për importim të energjisë ishin të lidhura me kompanitë e huaja, gjuha e punës ka qenë anglishtja. Mirëpo, nëse ato nuk përkthehen mund të jetë kufizim për përdoruesit dhe shfrytëzuesit e këtyre dokumentacioneve.

Kontrollet e dobëta në procesin e pagesës së faturave për import të energjisë

Zotimi i mjeteve me rastin e inicimit të procedurave për importim të energjisë nuk ishte regjistruar në kodin adekuat të buxhetit. Të dhënat e paraqitura në dokumentin e Udhëzimit për Pagesë (i plotësuar nga prokurimi në kohën e ekzekutimit të pagesave) nuk përputhen më të dhënat në faturë dhe kontratë (emri i kompanisë, numri i kontratës dhe zotimi i mjeteve).

Këto mangësi dhe gabime nuk janë korrigjuar me rastin e çertifikimit dhe ekzekutimit të pagesave. Kjo tregon se kontrollet financiare nuk kanë funksionuar si duhet në këtë proces.

Konkluzioni

KEK-u në përgjithësi është duke e menaxhuar procesin e importit të energjisë elektrike në pajtim me praktikat e Federatës Evropiane të Tregtareve të Energjisë. Menaxhimi me disa lloje të kontratave ka ndikuar në optimizim të sistemit dhe kursimin e mjeteve financiare.

Pavarësisht kësaj ne kemi vërejtur se kontrollet e brendshme në këtë proces janë të pamjaftueshme. Gabimet kanë ndodhur gjatë tërë procesit, prej fazës së zotimit e deri të certifikimi i pagesave. Kjo rritë rrezikun e gabimeve në ekzekutimin e pagesave.

Rekomandim 3

Ne rekomandojmë Bordin e KEK-ut të siguroj:

- Që kontratat e lidhura me kompanitë e ndërkombëtare për import të energjisë elektrike, të përkthehen edhe në gjuhët zyrtare. Kjo do të lehtësonte përdorimin e tyre; dhe
- Kontrole funksionale gjatë procesit të pagesave, duke regjistruar të gjitha të dhënat sipas kodeve adekuata të buxhetit.

2.2 Blerjet e energjisë elektrike brenda vendit

KEK për vitin 2010 kishte planifikuar blerjen e energjisë nga hidrocentralet vendore në vlerë prej 3,000,000€ Shpenzimet aktuale për blerje ishin 4,835,464.31€ apo rreth 61% më të larta në krahasim me planin.

Tejkalimi i buxhetit për 61% ka ndodhur për arsye se prodhuesit privat të energjisë elektrike nuk po bëjnë planifikim të mirë dhe me kohë lidhur me kapacitetet e tyre vjetore. Po ashtu dy kompani prodhuese të energjisë nuk kishin dorëzuar më kohë në KEK planifikimin vjetor të prodhimit.

Gjatë periudhës 2010 KEK-u kishte kontrata me 5 prodhues vendor të energjisë:

- HC Ibër Lepenc;
- HC Lumbardhi;
- HC Dikanci;

- HC Drini i Bardhë; dhe
- AEG Golesh.

Ne kemi testuar rregullsinë e kontratave dhe kemi bërë testimin e 16 pagesave në vlerë prej 2,303,982€ ose rreth 47% e totalit për këtë kategori të shpenzimeve. Auditimi ynë ka shpalosur të gjeturat në vijim:

Vonesa në pagesën e faturave nga ana e KEK-ut

Nga testimet e pagesave për 16 fatura, shtatë prej tyre ishin ekzekutuar më vonesë prej tetë deri në 33 ditë vonesë.

KEK nuk kishte instaluar sistem të mirë të kontrollit gjatë ekzekutimit të pagesave. Programi i pagesave në kuadër të KEK-ut parasheh që pagesat të bëhen brenda 45 ditëve, e në anën tjetër kontratat individuale me blerësit vendor parashohin një afat pagese brenda 30 ditëve.

Vonesat në ekzekutimin e pagesave mund të sjellin KEK-un para ndëshkimeve të mundshme financiare.

Prezantim jo i plotë i detyrimeve për blerjen vendore të energjisë elektrike

KEK-u ka nënshkruar një kontratë për blerjen e energjisë me AEG-Golesh. Kjo kontratë parasheh kushtet dhe çmimin për një MWh. Prej kësaj kompanie, KEK-u ka pranuar 470 MWh energji elektrike. Mirëpo, kjo energji nuk është faturuar dhe vlera e saj financiare nuk është regjistruar në regjistrat e kontabilitetit të KEK-ut.

Si pasojë obligimet e prezantuara në pasqyrat financiare të KEK-ut janë të nënvlerësuar.

Konkluzioni

Bazuar në të gjeturat e prezantuara për blerjet vendore të energjisë vijmë në konkluzionin se nuk kishte menaxhim të mirë nga të dy palët kontraktuese. Në njërin anë kompanitë prodhuese të energjisë elektrike nuk i kishin ofruar të dhënat e nevojshme KEK-ut më rastin e planifikimit, e në anën tjetër KEK-u nuk ka arritur t'i përmbushë obligimet e kontraktuara me kohë.

Rekomandimi 4

Ne rekomandojmë Bordin e KEK-ut të siguroj:

- Që të gjitha kompanitë vendore prodhuese kanë sjellë me kohë planifikimet vjetore për kapacitetet e tyre prodhuese; dhe
- Kontrolle adekuate gjatë procesimit të pagesave. Pagesat të behën në përputhje me kontratën, si dhe të paraqiten drejtë të gjitha obligimet e organizatës.

2.3 Shkëmbimet e energjisë elektrike

KEK ka realizuar marrëveshje për shkëmbimin e energjisë elektrike me disa kompani elektroenergjetike të vendeve të ndryshme. Kjo është bërë me qëllim të krijimit të kushteve për stabilizimin e sistemit elektroenergjetik, përkatësisht shfrytëzimin optimal të tepricave ose mungesave të energjisë elektrike.

Gjatë vitit 2010 shkëmbimet janë realizuar kryesisht me Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare (KESH), por ka pasur edhe shkëmbime me Kompanitë Zvicerane, Energy Financing Team (EFT) dhe ElektrizitatsGesellschaft Laufenburg AG (EGL).

Shkëmbimet e energjisë elektrike që ka realizuar KEK gjatë vitit 2010 shprehur në MWh

Muaji	Importuar nga KESH	Eksportuar nga KESH-it	Eksportuar nga EGL-së	Eksportuar nga EFT-së	Bilanci
Janar	-66020				-66020
Shkurt	-12625	320	60		-12245
Mars	-1870	9520	720		8370
Prill	-17710	1500			-16210
Maj	-17386	4132		360	-12894
Qershor		60407			60407
Korrik		5928		4230	10158
Gusht		17154		1600	18754
Shtator		29912	935	3290	34137
Tetor	- 14 547	5 299	94	8 640	- 514
Nëntor	-1000	1350			350
Dhjetor	-480				-480
Totali	-131638	135522	1809	18120	23813

Nga tabela shohim se KEK ka eksportuar 23,813MWh më shumë se sa ka importuar energji ne formë të shkëmbimeve.. Eksportet janë bërë kryesisht gjatë orëve të vona të natës kur KEK-u ka tepricë të energjisë elektrike.

Pjesa më e madhe e shkëmbimeve ishte realizuar me KESH-in ku ishte një bilanc përafërsisht i barabartë (marrje-dhënie). Ndërsa me kompanitë EGL dhe EFT vetëm ka eksportuar energji elektrike, për shkak se KEK-u kishte borxh të vjetër ndaj tyre, andaj kishte realizuar kthimin e borxhit. Derisa këto kompani tregtare të energjisë nuk ishin të interesuara për të dhënë energji në formë të shkëmbimeve.

Auditimi ynë është fokusuar në shkëmbimet e energjisë elektrike ndërmjet KEK-ut dhe KESH-it të realizuara gjatë vitit 2010. Testimet tona detaje kanë përfshirë muajt Prill, Tetor dhe Dhjetor.

Sipas testimëve të bëra, kemi vërejtur se shkëmbimet e energjisë elektrike janë realizuar sipas kushteve të parapara në marrëveshje.

VIII. Kontrolli mbi menaxhimin

VIII.1 Sistemi i kontrollit të brendshëm

Sistemi i mirë i kontrollit të brendshëm e ndihmon çdo organizatë buxhetore në arritjen e objektivave të përcaktuara në shfrytëzimin sa më të mirë të parave publike, duke siguruar raportim të besueshëm financiar dhe operativ.

Konkluzioni

Duke ju referuar të gjeturave të këtij raporti, vijmë në konkluzionin se KEK ende nuk ka arritur të vendos sistem funksional të kontrollit të brendshëm i cili do të siguronte një menaxhim të duhur dhe sistem të besueshëm financiar.

Rekomandim 5

Ne rekomandojmë Bordin e KEK-ut të siguroj:

- Funksionim adekuat të kontrollit në mënyrë që të parandalohen gabimet dhe parregullsitë e mundshme, duke siguruar arritjen e objektivave të përcaktuara.

VIII.2 Auditimi i brendshëm

Auditimi i brendshëm është segment i rëndësishëm i cili duhet ti jap siguri menaxhmentit të lartë se sistemet e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe zbatohen në mënyrën e duhur. Nëse vërehet se kontrollet e brendshme nuk funksionojnë siç janë paraparë, auditimi i brendshëm do të ofrojë këshilla dhe rekomandime se si të përmirësohen ato.

Gjatë vitit 2010 Njësia e Auditimit të Brendshëm kishte bërë auditime me objektiva të ndryshme gjatë vitit 2010. Ndërsa lidhur me objektiven tonë të auditimit ndërlidheshin dy raporte: Raporti i kryer në Departamentin e Menaxhimit të Kapaciteteve “Auditimi i procedurave për Shitjen e Energjisë Elektrike të Natës” dhe “Auditimi i Donacioneve dhe Grandeve Qeveritare” për vitin 2009.

Ne këto raporte janë dhëne disa rekomandime lidhur me përmirësimin e sistemit të kontrollit, dhe regjistrimet e duhura kontabël të granteve qeveritare, mirëpo KEK nuk kishte arritur t’i adresoj të gjitha rekomandimet e tyre.

Rekomandimi 6

Ne rekomandojmë Komisionin e Auditimit dhe Bordin e KEK-ut të sigurojnë:

- Adresimin e vazhdueshëm të rekomandimeve nga auditimi i brendshëm, në mënyrë që të përmirësohet edhe me tutje sistemi i kontrollit të brendshëm.

IX. Një konkluzion i përgjithshëm mbi Menaxhmentin e KEK

Menaxhimi i subvencionit qeveritar nga KEK-u ishte bërë në përputhje më qëllimin e dedikuar në marrëveshjen MEF-KEK.

KEK-u ka siguruar disa kontrata fleksibile për disa lloje të energjisë elektrike, duke arritur të rrisë furnizimin e energjisë elektrike si dhe të ndikoj në optimizmin e sistemit elektroenergjetik.. Këto forma të kontratave janë të nxjerra sipas rregullave të EFET.

Mirëpo, edhe përkundër kësaj KEK-u nuk kishte arritur të shpenzoj të gjitha mjetet e dedikuara për import të energjisë elektrike për vitin 2010. Në të njëjtën kohë furnizimi më energji elektrike nuk ishte stabil (në këtë periudhë kishte reduktime ndaj konsumatorëve).

KEK-u gjatë vitit 2010 kishte realizuar shkëmbime të energjisë elektrike kryesisht me Korporatën Energjetike Shqiptare (KESH). KEK-u kishte eksportuar me shume në krahasim me importet për 23,813 MWh.

Derisa prodhuesit vendor të energjisë nuk kishin ofruar planifikim të mirë për kapacitetet e tyre prodhuese. Ndërsa KEK-u nuk kishte arritur t'i përmbushë me kohë të gjitha obligimet e kontraktuara ndaj tyre (vonesa gjatë ekzekutimit të pagesave).

Rekomandimi i përgjithshëm

Ne rekomandojmë Bordin e KEK-ut që:

- Të forcohet niveli i menaxhimit të përgjithshëm në procesin e importimit, blerjeve vendore dhe shkëmbimeve të energjisë, duke pasur objektivë stabilizimin e furnizimit më energji elektrike në vend.

Shtojca I. Komentet e KEK-ut dhe përgjigja e ZAP-it

Menaxhmentit të KEK-ut i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij Raporti. Menaxhmenti ka pranuar të gjeturat dhe konkluzionet tona të paraqitura në Raportin e auditimit për importin, blerjet vendore dhe shkëmbimet e energjisë për vitin 2010 dhe nuk ka dhënë ndonjë koment.

Më tutje, ata janë zotuar se do ti bëjnë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.